



1583  
25.07.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 487, datë 21.7.2022

P Ë R

**TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE  
TË PERSONELIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 70, pikat 1, shkronja "a" dhe 3, të ligjit nr.128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve" dhe të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:
  - a) Punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore me status të veçantë (në vijim, punonjësit e Agjencisë), sipas përcaktimeve të ligjit nr.128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore";
  - b) Nëpunësit civilë të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
  - c) Punonjësit administrativë/mbështetës të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Agjencisë janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Elementet e pagës janë, si më poshtë vijon:
  - a) Paga për funksion, kolona 2, e lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, është niveli i pagës për çdo funksion organik të punonjësve të Agjencisë;

- b) Shtesa për natyrë të veçantë pune, kolona 3, e lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, është shtesa që përfitojnë këta punonjës për shkak të veçorisë së punës e shërbimeve që kryejnë;
  - c) Shtesa për çdo vit vjetërsi në detyrë, që llogaritet në masën 1 (një) për qind të:
    - i. pagës për funksion, për funksionet organike “ndihmësspecialist” dhe “specialist në drejtoritë rajonale”, por jo më shumë se 25 vjet; dhe
    - ii. pagës për funksion, të funksionit organik “specialist në drejtorinë e Përgjithshme”, për të gjitha funksionet e tjera organike, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.
3. Për efekt të llogaritjes së shtesës për çdo vit vjetërsi në detyrë, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, vite vjetërsie në detyrë do të konsiderohen:
- a) vitet e qëndrimit në detyrë të dokumentuara me librezën e punës apo në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, së çdo punonjësi në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore dhe në ish-Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat;
  - b) vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara me librezën e punës apo në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, së çdo punonjësi në strukturat e Gardës së Republikës, Policisë së Shtetit, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Forcave të Armatosura, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Policisë së Burgjeve, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.
4. Gjatë periudhës së trajnimit në Akademinë e Sigurisë, aplikantët, të cilët shpallen fitues dhe që në momentin e shpalljes fitues nga procesi i konkurrimit emërohen në funksionet organike, përfitojnë pagën për funksion të funksionit organik ku ata janë emëruar.
5. Kategoritë e pagave për nëpunësit civilë janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Vlerat e elementeve përbërëse të secilës kategori page (paga e grupit, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e pozicionit) janë sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë të institucioneve të administratës publike.
6. Shtesa për natyrë të veçantë pune për nëpunësit civilë të Agjencisë është sipas përcaktimit në kolonën 3, të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

7. Kategoritë e pagave për pozicionet e punës të nëpunësve civilë me emërtesë të njëjtë, përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së institucionit.
8. Nëpunësit civilë në pozicionet “specialist”, “përgjegjës sektori” apo “drejtor drejtorie”, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të Agjencisë, përfitojnë shtesën përkatëse, sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë të institucioneve të administratës publike.
9. Pagat e punonjësve mbështetës përcaktohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike.
10. Vendimi nr.149, datë 18.2.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, të ndryshuar, shfuqizohet.
11. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e Ministrisë së Brendshme.
12. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2023.

**KRYEMINISTRI**

**EDIRAMA**

**Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e  
Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**

<b>Nr.</b>	<b>Funksioni organik</b>	<b>Paga për funksion</b>	<b>Shtesa për natyrë të veçantë pune</b>
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
1	Ndihmës specialist (vëzhgues/mbikqyrës) në trupën operacionale.	60000	15000
2	Ndihmës specialist (përpunues informacioni) në kartotekë.	60000	10000
3	Specialist në drejtoritë rajonale.	80000	15000
4	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme.	85000	12000
5	Specialist për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik (VETING-un).	85000	20000
6	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale.	89000	17000
7	Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme.	95000	15000
8	Përgjegjës sektori për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik (VETING-un).	95000	20000
9	Titullar i drejtorisë rajonale.	95000	20000
10	Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme.	104000	17000
11	Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm.	104000	0
12	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm.	110000	22000
13	Drejtor i Përgjithshëm.	120000	30000

**Kategoritë e pagave dhe shtesat për natyrë të veçantë pune për nëpunësit civilë të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**

<b>Nr.</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Kategoria e pagës</b>	<b>Shtesa për natyrë të veçantë pune</b>
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
<b>1</b>	Drejtor drejtorie në drejtorinë e përgjithshme	III-a	7000
<b>2</b>	Përgjegjës/Shef sektori buxhet&financë në drejtorinë e përgjithshme	III-a/1	5000
<b>3</b>	Përgjegjës/Shef sektori në drejtorinë e përgjithshme.	III-a/1	0
<b>4</b>	Specialist/zëdhënës shtypi në drejtorinë e përgjithshme.	III-b	0
		IV-a	0
<b>5</b>	Specialist në drejtoritë rajonale	IV-a	0
		IV-b	0

NR.PROT. 4218/2  
DATE 22-7 2022

KRYEMINISTRISË  
MINISTRISË SË BRENDSHME  
AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**



**Engjëll AGAÇI**

*Engjëll Agaçi*